




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Kon.Nr.1/25
Datë: 27.01.2025

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6, neni 39, si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në shkresën e Moneta Sh.p.k e datës 30.07.2024, me Nr. Prot: 481/24-01/H, në mbledhjen e mbajtur me datën 27.01.2025 nxjerr këtë:

KONKLuzion

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak, konstaton se nuk ka kushte për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Komunave të Kosovës sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit nr. 08/L056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Arsyetim

Autoriteti me datë 30.07.2024, ka pranuar shkresën nga (IFJB) Moneta Sh.p.k me Nr. Prot: 481/24-01/H, me të cilën ka kërkuar nga Autoriteti të nxjerr aktin administrativ sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJUZVP. Nr. 119/2021 i datës 01.12.2021.

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës (tash e tutje Autoriteti), me datë 16.03.2022, ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me datë 01.12.2021, ARJ.UZVP. Nr.119/2021 me të cilin, (në kohën kur aktgjykimi është pranuar në Autoritet Komisioni i Autoritetit nuk ka qenë funksional) ka anuluar vendimin e Autoritetit Nr.41/16 datë 06.12.2016, çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Autoriteti lidhur me rastin ka vepruar sipas sugjerimeve dhe konstatimeve të këtij Aktgjykimi.

TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit – do të konsiderohet Ofrimi i Shërbimit të Pagesave të IFJB-ve.

Objekt i shqyrtimit në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak në kohën e marrjes së vendimit, kanë qenë: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet MPB/ARC, Postës së Kosovës Sh.A. dhe Marrëveshjet/Kontratat ndërmjet komunave të Kosovës - Postës së Kosovës Sh.A, (IFJB) dhe operatorëve tjerë ekonomik në tregun përkatës.

Autoriteti kishte konsideruar se Institucioni financiar jo bankar (IFJB) - është person juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është licencuar nga BQK-ja, (sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare) për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënie financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operacionale, si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

Institucionet Financiare jo Bankare janë:

1. IFJB MONETA Sh.p.k.
2. IFJB VLLESA CO Sh.p.k.
3. IFJB POSTA E KOSOVËS Sh. A.
4. IFJB PROPAID Sh.p.k.
5. IFJB CAPITAL Sh.p.k.

Institucionet e licencuara kanë veprimtaritë/aktivitetet si në vijim:

- Transfer parash;
- Shërbimi i pagesave;

Transfer hyrëse/dalëse; Shërbime të pagesave juridike, të dokumenteve personale, të regjistrimit të veturave, të taksave, shërbime tjera të ngjashme si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

Posta e Kosovës është shoqëri aksionare, e themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-087, Mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe është themeluar si entitet legal me

ndarjen e Shoqërisë Aksionare "Posta dhe Telekom i Kosovës" Sh. A. bazuar në vendimin e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës Nr. 16/53 i datës 21.12.2011, vendimit të MZHENJPMNP (Njësia për Mbikëqyrjen e Ndërmarrjeve Publike) e datës 2 1.09.201 1.

Pasta e Kosovës Sh.A. është e licencuar si IFJB nga Banka Qendrore e Kosovës për kryerjen e këtyre aktiviteteve:

- Shërbimi i pagesave;
- Shërbime të pagesave juridike, dhe dokumenteve personale, të regjistrimit të veturave, të taksave si dhe shërbime tjera të ngjashme.

Gjendja faktike

Në kohën kur Autoriteti ka nxjerr aktin administrativ gjendja faktike ka qenë si në vijim:

Posta e Kosovës Sh. A. ka funksionuar në selinë e Agjencisë të Regjistrimit Civil, në shumicën e Qendrave të Regjistrimit Civil (QRC) në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve (QRA) në Komunën e Prishtinës, Gjiçanit dhe Mitrovicës.

Komuna e Gjakovës përmes një Kontrate për qiranë e lokalit afarist është vendosur Banka Ekonomike.

Komuna e Ferizajt, ka lidhur Kontratë për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me qira me IFJB VLLESA-CO.

Komuna e Pejës ka shpallur tender për ofrimin e shërbimeve të pagesave, në të cilin tender ka fituar IFJB VLLESA-CO.

Autoriteti gjatë monitorimit/shqyrtimit paraprak në tregun përkatës, konsideron se gjendja faktike nuk ka ndryshuar.

Analiza e Konkurrencës

Autoriteti bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka mandat identifikimin e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet), përcaktimin e pozitës dominuese dhe keqpërdorimin e saj, me të cilat përcaktohen masat, kushtet dhe afatet për eliminimin e efekteve të dëmshme, dhe ndalimin e çdo sjelljeje të mëtejshme që çon në marrëveshje të ndaluar, keqpërdorim i pozitës dominuese, si dhe vlerësimi ex-ante i ndërmarrjeve në proces të përqendrimeve, në bazë të analizave të hollësishme ligjore dhe ekonomike sipas procedurave ligjore.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë, për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës.

Autoriteti kryen detyrat si një organi i pavarur për mbrojtjen e konkurrencës, në të gjitha tregjet ekskluzivisht brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara nga Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti zhvillimin e procedurës e bazon në neni 35 – Propozimi për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio neni 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 3 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës bën përkufizimin e definicionit të ndërmarrjes sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon: “Ndërmarrje - çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit. Organi publik quhet ndërmarrje nëse angazhohet në veprimtari ekonomike”.

Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Komunitet e Kosovës, sipas politikës së konkurrencës në rastin konkret bazuar në veprimtarinë e saj, nuk konsiderohen ndërmarrje në kuptim të nenit 3 Ligjit Nr. 08/L 056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, që kryen aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk operon në treg, përmes blerjes së mallrave ose shërbimeve nëse përdorimi pasues i mallrave ose shërbimeve të blera përbën veprimtari ekonomike. Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlen edhe për ndërmarrjet të cilave, në bazë të rregulloreve të veçanta, u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ndërmarrjeve që për nga natyra e tyre janë monopole dhe që krijojnë të ardhura ose atyre, në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive të caktuara, u është besuar kryerja e një veprimtarie të caktuar dhe atë vetëm në rastet kur zbatimi i LMK së nuk do të pengonte, ligjërisht dhe faktikisht, kryerjen e detyrave që u përcaktohen me rregullore dhe masa të veçanta dhe për të cilat janë krijuar këta persona.

Autoriteti konsideron edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Komunitet e Kosovës, bazuar në nenin 3 Ligjit Nr. 08/L 056 për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk konsiderohen ndërmarrje, Autoriteti analizoi marrëveshjet/kontrata siç janë:

1. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunitet së Prizrenit dhe Postës së Kosovës Sh,A. " me Nr. prot: 01-1052-15 e nënshkruar me datën 24.04.2015.
2. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Postës së Kosovës Sh. A." me Nr. prot: 01-1696/2015 e nënshkruar me datën 23.07.2015,
3. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunitet së Prishtinës dhe Postës së Kosovës Sh,A. "me Nr. prot: 01-031-75225 e nënshkruar me datën 03.04.2015.
4. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunitet së Gjilanit dhe Postës së Kosovës Sh. A. " me Nr.1573 e nënshkruar me datën 28.10.2015.

5. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Postës së Kosovës Sh. A." me Nr. prot: 01-31-83737 e nënshkruar me datën 15.10.2015.
6. "Kontrata për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me qira për ofrimin e shërbimit të pagesave ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe IFJB VLLESA-CO." me Nr. prot: ol206/16 e nënshkruar me datën 08. OZ 2016.
7. "Kontratë për qiranë e lokalit afaristë ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Banka Ekonomike" e nënshkruar me datën 25.03.2008.

Të gjitha Marrëveshjet/Kontratat e lartpërmendura nuk bien ndesh me nenin 5 Marrëveshjet e Ndaluar (kartelet), të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për shkak se: nenet përkatëse të marrëveshjeve/kontratave, përmbajnë vetëm të drejta dhe detyrime në mes palëve.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Salihe Gashi Loku
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen

- Moneta Sh.p.k
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva